



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Numri i Çështjes	71016-00942-11-2012	Data e Regjistrimit	7/16/2012
Numri i Vendimit	11-2012-7446	Data e Vendimit	10/18/2012

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRES E PERBERE NGA:

KRYESUES: Astrit Faqolli
ANËTAR Lazer Sallaku
Tritan Hamitaj
SEKRETARE Astrit Faqolli

Objekti: Lëshimi i urdhërit të ekzekutimit për vendimin përfundimtar nr. 359 datë 18.06.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës: Heqjen e masës së sigurimit "Sekuestro Preventive" mbi objektin Bar-Restorant-Hotel "Iliria International" që ndodhet në lagjen nr. 13 Plazh Durrës rregjistruar në Z.R.P.P Durrës në emër të shtetases Vaje Sulejman Kapciu nr. 24 rregj Hipotekor datë 08.02.2002, Zona Kadastrale 8518 me nr. Pasurie 44/66 volumi 11, faqe 40 të vendosur me vendimin nr. 942 datë 22.12.2011 të Gjy

Baza Ligjore : Neni 274/3, 275/1, 388, 389 të K.Pr.Penale

Përmbledhja e vendimit:

Gjykata pasi dëgjoji palët të cilët kërkuan ;

Kërkuesi ***** dhe avokati i tij – Pranimin e kërkesës

Prokurori Afrim Shehu – Rrëzimin e kërkesës.

Kërkuesi ***** me kërkesë drejtuar kësaj gjykatës ka kërkuar lëshimim e urdhërit të ekzekutimit për vendimin përfundimtar nr. 359 datë 18.06.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në lidhje me heqjen e masës së sigurimit "Sekuestro Preventive" mbi objektin Bar-Restorant-Hotel "Iliria Internacional" që ndodhet në lagjen nr. 13 Plazh Durrës rregjistruar në Z.R.P.P Durrës në emër të shtetases Vaje Sulejman Kapciu nr. 24 rregj Hipotekor datë 08.02.2002, Zona Kadastrale 8518 me nr. Pasurie 44/66 volumi 11, faqe 40 të vendosur me vendimin nr. 942 datë 22.12.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Kjo çështje u gjykua me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë për shkak se gjyqtarja Shpëtime Pitaku, e cila e ka pasur për shqyrtim këtë çështje, me vendimin e datës 17.09.2012, ka shpallur moskopetencën për gjykimin e kësaj çështje dhe kalimin e saj për kopetencë gjykimi trupit gjykues që ka gjykuar themelin e çështjes.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Gjykata, vendosi të thërrasë si palë në gjykim dhe organin e prokurorisë pasi, bazuar në nenin 471/4 të Kodit të Proçedurës Penale, çmoi se kjo çështje hyn tek ato çështje që lidhen me ekzekutimin e vendimeve dhe seanca gjyqësore zhvillohet me pjesëmarrjen e domosdoshme të prokurorit.

Në gjykim rezultoi se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është gjykuar çështja penale në ngarkim të të pandehurit *****akuzuar për veprën penale të "Pastrimi i produkteve të veprës penale", parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal.

Me vendimin nr.359, datë 18.06.2012, Gjykata ka vendosur:

Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit *****akuzuar për veprën penale të "Pastrimi i produkteve të veprës penale", parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal.

Heqjen e masës së sigurimit "Sekuestro Preventive" mbi objektin Bar-Restorant-Hotel "Iliria Internacional" që ndodhet në lagjen nr. 13 Plazh Durrës regjistruar në Z.R.P.P Durrës në emër të shtetases Vaje Sulejman Kapciu nr. 24 rregj Hipotekor datë 08.02.2002, Zona Kadastrale 8518 me nr. Pasurie 44/66 volumi 11, faqe 40 të vendosur me vendimin nr. 942 datë 22.12.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe kthimin e saj shtetases Vaje Sulejman Kapxhiu.

Ky vendim nuk ka marrë formë të prerë pasi është apeluar nga prokurori.

Kërkuesi ***** me kërkesë drejtuar kësaj gjykatës ka kërkuar lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për heqjen e masës së sigurimit "Sekuestro Preventive" mbi objektin Bar-Restorant-Hotel "Iliria Internacional".

Këtë kërkesë kërkuesi argumentoi se e ka bërë pasi i është drejtuar me kërkesë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, regjistruar më datë 21.06.2012, për zbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës vetëm përse i përket heqjes së sekuestros preventive, por nga Prokuroria e Rrethi Gjyqësor Durres nuk është zbatuar ky vendim si dhe nuk i është kthyer një përgjigje lidhur me kërkesën bërë, prandaj ai i është drejtuar po kësaj gjykate që ka nxjerrë këtë vendim për "Lëshimin urdhërit të ekzekutimit për vendimin përfundimtar nr. 359 datë 18.06.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës".

Kërkesën e tij kërkuesi e bazon në Kodit të Proçedurës Penale dhe në ligjin Nr.8331, datë 21.4.1998 "Per ekzekutimin e vendimeve penale", duke argumentuar se ligjvënësi është shprehur se në rastet e sekuestros preventive efektet e saj janë në varësi të rrethanave dhe gjykata, qoftë gjatë hetimit paraprak dhe natyrisht në cdo fazë të procesit gjyqësor mund ta heqë këtë masë siguri.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Në kërkesën e tij ai parashtroi se:

Në nenin 274/3 është parashikuar se: *“Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, heq sekuestron”*

Në nenin 275/1 është parashikuar se: *“Me vendimin e pafajësisë ose të pushimit të çështjes, gjykata ose prokurori urdhëron që sendet e sekuestruara ti kthehen atij që i takojnë, kur nuk duhet të urdhërojë konfiskimin e tyre sepse kanë shërbyer ose ishin të destinuara për të kryer një vepër penale ose sepse kanë qënë prodhim ose përfitim nga vepra penale”.*

Në nenin 462/2 të Kodit të Proçedurës Penale është parashikuar se: *“ Vendimi i pafajësisë, i përjashtimit të të gjykuarit nga dënimi dhe ai i pushimit të çështjes , vihet në ekzekutim menjëhere pas shpalljes”.*

Në nenin 463/1 të Kodit të Proçedurës Penale është parashikuar se: *“ Prokurori pranë Gjykatës së Shkallës së Parë që ka dhënë vendimin, merr mesa për ekzekutimin e vendimit “.*

Në nenin 466 të Kodit të Proçedurës Penale është parashikuar se: *“Masat e sigurimit të urdhëruara nga gjykata, ekzekutohen nga prokurori pranë gjykatës që ka dhënë vendimin ”.*

Gjithashtu kërkesën e tij kërkuesi e bazoi edhe në Ligjin Nr.8331, datë 21.4.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale" përkatësisht në nenet:

a) Neni 2. *“Me ekzekutim të vendimit penal kuptohet zbatimi i urdhërimeve që përmban vendimi penal i formës së prerë dhe i vendimeve që, sipas K.Pr.Penale, kanë ekzekutim të menjëhershëm, me synimin e riedukimit të të dënuarve, të rivendosjes së të drejtave të personave të proçeduar padrejtësisht. .. ”.*

b) Neni 8. *Përgjegjësia e organeve të ekzekutimit “Organet dhe punonjësit që ekzekutojnë vendimet sipas këtij ligji, janë të detyruar të ushtrojnë me korrektësi kompetencat, duke respektuar të drejtat, nderin dhe dinjitetin e personit. Personat e ngarkuar për ekzekutimin e vendimit penal mbajnë përgjegjësi disiplinore dhe, kur është rasti, edhe penale,për mos vënien, zvarritjen ose ekzekutimin e vendimit në kundërshtim me ligjin apo të drejtat e personit.”*

c) Neni 9. *Prokurori “Prokurori është i detyruar të marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit në përputhje me urdhërimet e gjykatës dhe kërkesat e këtij ligji, të kontrollojë rregullsinë e ekzekutimit, të ndërhyjë në organet kompetente ose të paraqesë kërkesë në gjykatë për rivendosjen e ligjit e të së drejtës së shkelur dhe vënien e shkaktarëve para përgjegjësisë sipas ligjit.*
”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

d) Neni II. Gjykata. *“Për vendimet penale me ekzekutim të menjëhershëm urdhërimet i jep gjykata që ka dhënë vendimin menjëherë pas shpalljes së tij”.*

e Neni 12. *“Prokurori është organi që ve në lëvizje procedurën e ekzekutimit të të gjithë vendimeve të tjera penale dhe në mbështetje të neneve 463 dhe 468 të Kodit të Procedurës Penale, proçedon vetë ose urdhëron organet e tjera për vënien në ekzekutim të vendimit sipas Kodit të Procedurës Penale, sipas këtij ligji dhe dispozitave të tjera ligjore”.*

f) Neni 21. Ekzekutimi i menjëhershëm *“Ekzekutohen me urdhër të gjykatës menjëherë pas shpalljes së vendimit: Vendimet penale që përmbajnë pafajësi, përjashtimin e të gjykuarit nga dënimi ose pushimin e gjyqimit të çështjes sipas pikës 2 të nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale.*

Përfaqësuesi i organit të prokurorisë në pretendimet e tij parashtroi se:

Në aspektin e formës së kërimit objekti i kërkesës nuk është i ligjshëm. Vendimet penale të formës së prerë vihen në ekzekutim vetëm nga Prokurori dhe jo nga Gjykata. E drejta dhe procedura e ekzekutimit të vendimeve penale është parashikuara në Titullin e IX, kreu I-rë i K.Pr.Penale ku është parashikuar se vetëm prokurori ve në ekzekutim vendimet penale të formës së prerë.

Edhe në ligjin Nr. 8331 datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale" i azhurnuar, është parashikuar se është Prokurori organi që ekzekuton vendimet penale të formës së prerë.

Në zbatim të këtij ligji është vetëm një moment që Gjykata merr pjesë në ekzekutimin e vendimeve të saj. Ky moment është faza e ekzekutimeve të menjëhershme.

Në këtë fazë të ekzekutimit urdhërimet i jep Gjykata që ka dhënë vendimin menjëherë pas shpalljes së tij.

Vendimet që i nënshtrohen procedurës së ekzekutimit të menjëhershëm, janë parashikuar në nenin 21 të ligjit Nr. 8331 datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale" i azhurnuar. Heqja e masës së sigurimit pasuror "Sekuestro preventive" nuk parashikohet në procedurën e ekzekutimit të menjëhershëm nëpërmjet urdhërimeve të Gjykatës.

Në rastet e tjera është Prokurori organi që ve në lëvizje procedurën e ekzekutimit të vendimeve penale të formës së prerë.

Së dyti: Në aspektin e përmbajtjes është një kërkesë e paligjshme pasi vendimi i gjykatës nuk është i formës së prerë dhe si i tillë nuk mund të vihet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

në ekzekutim as nga Prokurori as nga Gjykata.

Me datë 26.06.2012, nga Prokurori është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Durrës kundër vendimit Nr. 359 datë 18.06.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Pas shqyrtimit nga kjo gjykatë, vendimi konsiderohet i formës së prerë dhe duhet vënë në ekzekutim nga Prokurori, në përputhje me kriteret ligjore.

Gjykata para se të vendosë lidhur me bazueshmërinë ligjore të kërkesës, diskutoi nëse vendimi për heqjen e sekuestros preventive a do të konsiderohet me ekzekutim të menjëhershëm.

Gjykata, çmon se ky vendim është me ekzekutim të menjëhershëm pasi ligjvënësi ka parashikuar rastet kur masa e sigurimit pasuror hiqet dhe kur ajo duhet mbajtur dhe kjo pikërisht në Kreun e VI, Seksioni i I dhe II i Kodit të Proçedurës Penale.

Në nenin 275/1 të Kodit të Proçedurës Penale është përcaktuar se: *“Me vendimin e pafajsisë ose të pushimit të çështjes, gjykata ose prokurori urdhëron që sendet e sekuestruara t'i kthehen atij që i takojnë, kur nuk duhet të urdhërojë konfiskimin e tyre sepse kanë shërbyer ose ishin të destinuara për të kryer një vepër penale ose sepse kanë qënë prodhim ose përfitim nga vepra penale”.*

Pra sipas kësaj dispozite ligjvënësi ka parashikuar që sekuestroja preventive hiqet menjëherë pas dhënies së vendimit të pafajësisë apo të pushimit të çështjes dhe jo kur vendimi të marrë formë të prerë . Kjo sekuestro hiqet me urdhërimet e gjykatës ose prokurorit.

Edhe në Ligjin Nr.8331, datë 21.4.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale" neni 11 është parashikuar se: *“Për vendimet penale me ekzekutim të menjëhershëm urdhërimet i jep gjykata që ka dhënë vendimin menjëherë pas shpalljes së tij”.*

Në këtë rast gjykata e ka dhënë urdhërimin e saj kur ka vendosur heqjen e sekuestros preventive menjëherë pas shpalljes së vendimit dhe në këtë fazë të shqyrtimit të kërkesës, gjykata nuk ka se ç'far urdhërimesh të japë, pasi nuk jemi në atë fazë proçedurale. Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit të kërkuar nga kërkuesi ***** nuk parashikohet nga asnjë dispozitë penale apo proçedurale penale që e ngarkon gjykatën me këtë detyrim.

Gjykata çmon se është prokurori ai që duhet të ekzekutojë vendimin e gjykatës, kjo e përcaktuar në ligjin nr. 8331 datë 21.04.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", në nenin 9 të tij ku thuhet se: *“Prokurori është i detyruar të marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit në përputhje me urdhërimet e gjykatës dhe kërkesat e këtij ligji, të kontrollojë rregullsinë e ekzekutimit, të ndërhyjë në organet kompetente ose të*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

paraqesë kërkesë në gjykatë për rivendosjen e ligjit e të së drejtës së shkelur dhe vënien e shkaktarëve para përgjegjësisë sipas ligjit. "

Gjithashtu edhe në nenin 12 të këtij ligji është përcaktuar se: "Prokurori është organi që vë në lëvizje procedurën e ekzekutimit të të gjithë vendimeve të tjera penale dhe në mbështetje të neneve 463 dhe 468 të Kodit të Procedurës Penale, proçedon vetë ose urdhëron organet e tjera për vënien në ekzekutim të vendimit sipas Kodit të Procedurës Penale, sipas këtij ligji dhe dispozitave të tjera ligjore".

Nga sa më sipër gjykata çmon se kërkesa e kërkuarit ***** është e pabazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet të rrëzohet.

Për keto arsye:

Gjykata bazuar në nenin 379 e vijues të Kodit të Procedurës Penale

Vendosi:

- Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit ***** me objekt Lëshimi i urdhërit të ekzekutimit për vendimin përfundimtar nr. 359 datë 18.06.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në lidhje me heqjen e masës së sigurimit "Sekuestro Preventive" mbi objektin Bar-Restaurant-Hotel "Iliria Internacional" që ndodhet në lagjen nr. 13 Plazh Durrës rregjistruar në Z.R.P.P Durrës në emër të shtetases Vaje Sulejman Kapciu nr. 24 rregj Hipotekor datë 08.02.2002, Zona Kadastrale 8518 me nr. Pasurie 44/66 volumi 11, faqe 40 të vendosur me vendimin nr. 942 datë 22.12.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve në Gjykatën e Apelit Durrës
- **U shpall në Durrës sot më datë 12.10.2012**

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.